

KONTRATË /AKT- THEMELIMI E SHOQËRISË THJESHTË  
"AEA Albania Energy Association"

---

**KONTRATË /AKT- THEMELIMI E SHOQËRISË THJESHTË  
"AEA Albania Energy Association"**

Sot më datë 09-03-2021 Anëtarët Themelues:

1. **Z. Erlet Shaqe**, i biri i Myslimit, i datëlindjes 12.11.1984, lindur në Lubonjë/Korçë dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal I41112048I, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.
2. **Znj. Dallëndyshe SHAQE** e bija e Lazes, e datelindjes 07.08.1958, lindur në Strëmbec/Përmet dhe banuese në Tiranë, identifikur me kartë identiteti me nr. personal F85807118N.

Të dy së bashku me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi, ranë dakort për krijimin e shoqërisë së thjeshtë "AEA Albania Energy Association" me kushtet e mëposhtme, të cilën e kanë themeluar në bazë të kësaj kontrate.

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ky akt rregullon positën juridike të shoqërisë, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, duke u bazuar në legjislacionin Shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

**KREU I**

**Neni 1  
Krijimi**

Shoqëria "AEA Albania Energy Association" themelohet si shoqëri e thjeshtë, bazuar në dispozitat 1074-1112 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria është person juridik privat.

Emri i shoqërisë së thjeshtë është "AEA Albania Energy Association " (me poshtë referuar si "shoqëria").

**Neni 2  
Personaliteti Juridik**



T | F a q e

KONTRATË /AKT- THEMELIMI E SHOQËRISË THJESHTË  
“AEA Albania Energy Association”

---

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jete rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar Personalitetin Juridik është pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

**Neni 3**  
**Selia e shoqërisë**

Selia e shoqërisë është në TIRANE ne adresen Rruga Jordan Misja, Kompleksi Gener 2, Hyrja D1, Tiranë, Shqipëri.

Veprimtaria e shoqërisë të thjeshtë do të zhvillohet në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të ndryshojë selinë e saj , mund te hapë adresa dytësore.

Shoqëria thjeshtë mund te çelë degë dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës se Shqipërisë. Ato hapen dhe prishen me vendim të të Asamblesë së Anëtarëve të saj.

**Neni 4**  
**Objekti i shoqërisë**

Ofrimin e shërbimeve inxhinierike dhe konsulencë, duke përfshirë por pa u kufizuar në: Konsulencë inxhinierike, teknike, ekonomike, të personave fizikë dhe juridike, vendas dhe të huaj, publike dhe/ose private si shoqëri tregtare, organizma tregtare në lidhje me çështjet inxhinierike projektuese, energjitike, projektimit dhe zbatimit, administrimin e biznesit, menaxhimin, marketingun virtual, konsulencë për raporte të ndryshme studimore, seminare dhe evente, në burimet në sektorët e biznesit elektro-energjitik, të industrisë brenda kufizimeve të parashikuara në ligj.

Shërbime në analizën e të dhënave, zhvillimit të biznesit, financiare, përkthime, aplikacione ueb, dhe softuerike.


**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë të thjeshtë “AEA Albania Energy Association” është pa afat dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Anëtarëve.

**Neni 6**  
**Regjistrimi i Shoqërisë**

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin.

Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi. Me vendim unanim të mbledhjes së Asamblesë së Anëtarëve, shoqëria mund te ndryshoje regjimin juridik të saj në

 2 | F a q e

KONTRATË /AKT- THEMELIMI E SHOQËRISË THJESHTË  
"AEA Albania Energy Association"

përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plote me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj, duke bërë edhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.

KAPITULLI - II  
KAPITALI, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

**Neni 6**  
**Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është 1.000 (nje mije) i ndare ne 2 (dy) kuota.  
Pronësia mbi kapitalin të shoqërisë është si më poshtë:

1. Anëtarë Z. **Erlet SHAQE**, është zotëruese e një kuote ne vlere 900 leke , që përbën 90 % të kapitalit themeltar.
2. Anëtarë Z. **Dallëndyshe SHAQE**, është zoteruese e një kuote ne vlere 100 leke , që përbën 10% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i anëtarëve themelues mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Anëtarët, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3(tre)vjetëve nga çasti i cenimit.

**Neni 7**  
**Menyra te fitimit dhe Kalimit te Kuotave**

Kuota te kapitalit të një shoqërie të thjeshtë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a)kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b)shitblerjes;
- c)trashëgimisë;
- ç)dhurimit;
- d)çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Anëtarët mund të transferojne lirishi kuotat e zotëruara me një marreveshje me shkrim.

**KREU III**  
**ORGANET E SHOQËRISË**

3 | Faq e

KONTRATË /AKT- THEMELIMI E SHOQËRISË THJESHTË  
“AEA Albania Energy Association”

---

Organi themelor i shoqërisë është Mbledhja e Asamblese së Anëtarëve e cila mund të mbledhet në çdo kohë kur administratori/ët, ose vete anëtarët e kërkojnë, duke lajmëruar 15 ditë përpara me shkrim.

Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve vendos për të gjitha problemet, me përjashtim të atyre që është vendosur ndryshe nga statuti.

**Neni 8**  
**Administrimi i Shoqërisë**

**Anëtarët me marreveshje në perputhje me nenin 1080 të Kodit Civil bien dakort se:**

Asambleja e anëtarëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë së thjeshtë.

Asambleja e anëtarëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë së thjeshtë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e anëtarëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë e thjeshtë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin në çfarëdo banke apo institucion financiar.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

**Neni 9**  
**Administrimi**

Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një Administrator i cili do të vepronte i vetëm.

Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e shoqërisë, me qëllim që të arrijnë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon Asamblesë së Anëtarëve.

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore. Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e organit

*A.*

*Arbëthago* 4 | F a q e

KONTRATË /AKT- THEMELIMI E SHOQËRISË THJESHTË  
“AEA Albania Energy Association”

administrativ. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të statutit apo për dëm të shkaktuara gjatë administrimit të shoqërisë.

Administratori shkarkohet me vendim të të gjithë anëtarëve për shkaqe të justifikuara.

Personi i mëposhtëm emërohet administrator i shoqërisë për një periudhë 3 vjeçare, me të drejtë riemërimi:

**Z. Erlet Shaqe**, i biri i Myslimit, i datëlindjes 12.11.1984, lindur në Lubonjë/Korçë dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal I41112048I, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.

**Neni 10**

**Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblja e anëtarëve;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së anëtarëve për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së anëtarëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkalleve, prokurorive të të gjitha shkalleve, bankat e të gjitha niveleve etj.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transfera etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës etj.

**Neni 11**

**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

*A.*

*Erlet Shaqe*

KONTRATË /AKT- THEMELIMI E SHOQËRISË THJESHTË  
"AEA Albania Energy Association"

---

**Neni 12**  
**Fitimi i Shoqërisë**

Fitimi neto i shoqërisë shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në shoqëri.

**Neni 13**  
**Mbyllja e Shoqërisë Likuidimi**

Kur vendoset mbyllja e shoqërisë, Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve cakton likuidatorin që realizon likuidimin e saj. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit edhe emrin "Shoqëri në likuidim e sipër". Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.  
Kur anëtarët pa shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata përfundimin e likuidimit. Aktet e përfundimit të likuidimit, se bashku me llogarite përkatëse përfundimtare. Depozitohen në QKB për çregjistrimin e shoqërisë.

**Neni 14**  
**Të Përgjithëshme**

Mosmarrëveshjet për statutin e shoqërisë do të zgjidhen nga vetë anëtarët me miëekuipim dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata kompetente.


Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 15**  
**Dispozita përfundimtare**

Kjo kontratë / Akt Themelimi u redaktua në 4 kopje me përmbajtje dhe vlere të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nën për nën nga Anëtarët e shoqërisë së thjeshtë "AEA Albania Energy Association", nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

Hartuar në Tiranë më **09/03/2021**.

Anëtarët themelues të shoqërisë thjeshtë "AEA Albania Energy Association "

1. **Erlet SHAQE** 

2. **Dallëndyshe SHAQE** 